



AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE

| Shkurt 2022 |

109.1%

realizimi planit
shkurt 2021

1.4 mld
\$

më shumë ose rreth
14 milionë dollar se plani

4 mld
lekë

ose 40 milionë dollarë
më shumë se
shkurti 2021


Shkurt
2022

doganat tejkalojnë
planin me 1.4 miliardë lekë

Muaji	Realizim 2021	Realizim 2022	Plan 2022	%2021-2022	Diferenca 2022-2021	Realizimi 2022 Realizimi 2021
Shkurt	12,233	16,232	14,875	132.8	4,009	32.8%

SHKURT 2013-2022/PLANI VS TE ARDHURAVE (MIJË LEKË)

Plan Total Përqindje



Administrata Doganore vijon performancën pozitive në drejtim të realizimit dhe tejkalimit të të ardhurave duke thyer rekordin historik me realizimin më të lartë të çdo muaji shkurt që prej vitit 2013, megjithëse vijon ndikimi nga situata e pandemisë.

Mirëadministrimi, shërbimi me cilësi 24/7 ndaj biznesit dhe qytetarëve, analizat paraprake të riskut dhe digjitalizimi shërbimeve kanë siguruar mirëfunksionimin e sistemit doganor dhe shifrat rekord në mbledhjen e të ardhurave buxhetore në dogana.

Të ardhurat në Shkurt 2022 janë realizuar në masën **16.2 Mld** lek nga **14.8 Mld** të planifikuara ose rreth **+1.4 Mld** lek më shumë. Në krahasim me Shkurt 2021 janë realizuar rreth **4 Mld** lek më shumë.

DOGANA DIGJITALE

AKSES ONLINE EDHE PËR 9 SHËRBIME TË REJA

Drejtoria e Procedurave Doganore do të implementojë edhe 9 shërbime duke ju shtuar 34 shërbimeve ekzistuese që realizohen online.

Shërbimet e reja që do ofrohen online janë:



- Autorizim për Regjim për Magazinim të Përkohshëm
- Autorizim për deklarim të thjeshtëzuar
- Urdhër për përjashtim nga rregulli i kompetencës territoriale
- Kërkesë për ndryshim/shtesa të autorizimit të Magazinimit të Përkohshëm
- Kërkesë për transferim mallrash nga një Autorizim RPA në një Autorizim RPA tjetër.
- Kërkesë për transferim mallrash nga një Autorizim RLP të pjesshëm në një Autorizim RLP të pjesshëm tjetër
- Kërkesë për ndryshim/shtesa të Autorizimit për Regjim të Përpunimit Pasiv
- Kërkesë për ndryshim/transferim të licencës për agjentë doganor
- Kërkesë për ndryshim/shtesa të autorizimit të Magazinimit Doganor

DOGANA KËRKON OPINIONET E BIZNESIT

PYETËSOR PËR PROCEDURAT DOGANORE

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bashkëpunoi në mënyrë efektive me biznesin dhe gjatë vitit 2021 ka përmirësuar performancën në këtë drejtim. Administrata Doganore mbetet e hapur për rekomandimet e sipërmarrjes lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve doganore ndaj dhe i drejtohet Biznesit me një Pyetësor. Analizimi i rezultateve të Pyetësorit do t'i shërbejë angazhimit të Administratës Doganore për vijimin e përmirësimeve të shërbimeve ndaj biznesit si nëpërmjet digjitalizimit, reduktimit të kohës së procedurave doganore dhe zgjidhjes së problematikës së mundshme që do të evidentohet.

Pyetësori gjendet në faqen zyrtare të Doganës Shqiptare:

<https://dogana.gov.al/c/378/pyetesor-per-biznesin>



BASHKËPUNIMI ME HOMOLOGËT

SHBA DHURON SKANER X PËR DOGANËN E RINASIT

Administratës Doganore Shqiptare iu dhurua nga Ambasada Amerikane në Tiranë, një skaner me rreze X, për kontrollin e bagazheve në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit.

Gjatë një ceremonie të organizuar me këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, falenderoi Qeverinë e SHBA, që nëpërmjet Ambasadës kanë mbështetur ADSH në projekte të ndryshme.



<https://dogana.gov.al/d/171/219/0/957/shba-dhuron-skaner-x-per-doganen-e-rinasit>

INFORMACION-A E DINI SE?

BLERJET ONLINE DHE DËRGESAT POSTARE

Çdo dërgesë mallrash me karakter jotregtar, e përbërë nga mallra me vlerë të papërfillshme, të dërguara drejtpërdrejt nga një vend tjetër të një marrësi në Republikën e Shqipërisë, përjashtohet nga detyrimet e importit.

- mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga interneti, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 22 euro;
- dërgesat e mallrave nga një individ jashtë RSh për një individ në R Sh, të një natyre rastësore, pa pagesë dhe që përbajnë vetëm mallrat e destinuar për përdorim personal ose familjar prej marrësit, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 euro.

BLINI ONLINE

dhe dërgoni me **POSTË!**

<https://dogana.gov.al/c/168/226/blerjet-online>

